

# **PARTIA LËVIZJA PËR ZHVILLIM KOMBËTAR (LZHK)**

## **HISTORIKU**

Partia Lëvizja për Zhvillim Kombëtar (LZHK) krijohet në vitin 2004, si një emërtim i ri i Partisë Demokratike të Rinovuar, e cila ishte krijuar më herët. Kryetari i LZHK vazhdon të mbetet Dashamir Shehi, i cili që në fillim të viteve 1990-të ishte shquar për bindjet e tij të djathta. Gjatë vitit 2005 kryetar ekzekutiv i Lëvizjes për Zhvillim Kombëtar (LZHK) është Leka I. Ndonëse një parti e djathtë, LZHK refuzon të kryejë një koalicion parazgjedhor me Partinë Demokratike, dhe futet në zgjedhje me një koalicion të partive që mbështesin ish mbretin Zog. Edhe për shkak të natyrës mikse të sistemit zgjedhor, rezultatet e zgjedhjeve të 3 korrikut 2005 nuk ishin shumë premtuese dhe vetë Leka Zogu deklaroi që nuk kishte asnjë lidhje me këtë koalicion. Në vitin 2007, Dashamir Shehi ishte kandidati i LZHK për zgjedhjet lokale në Tiranë, dhe konkuronte kundër dy kandidatëve kryesorë të dy partive të mëdha PD dhe PS. Gjatë zgjedhjeve të përgjithshme elektorale të vitit 2009, LZHK do të rreshtohej me koalicionin 'Poli i Lirisë', por pa arritur që të kishte ndonjë përfaqësues në parlament edhe për shkak të sistemit zgjedhor të votimit proporcional rajonal. Edhe zgjedhjet e përgjithshme elektorale të vitit 2013 nuk do të sillnin ndonjë ndryshim të dukshëm përsa i përket mandateve të deputetëve. Gjatë legjislaturës së fundit të vitit 2017, LZHK do të arrinte që të fitonte një mandat deputeti në parlamentin shqiptar, dhe i cili do të ishte mandati i kryetarit Dashamir Shehi. Vitet e fundit LZHK i është bashkuar koalicionit midis PD dhe LSI për rrëzimin e qeverisë Rama, duke mos u regjistruar as në zgjedhjet lokale të vitit 2019.

## **KRYETARI - Dashmir Shehi**

### **BIOGRAFIA**

Dashmir Shehi është një ndër figurat e spikatura të PD-së, që në vitet e para të themelimit të kësaj partie. Ai ka mbajtur poste të larta drejtuese gjatë qeverisjes së PD-së. Në vitin 1997 është larguar nga kjo parti, pas promemories ku ai propozoi dorëheqjen e qeverisë, në kulmin e krizës së vitit 1997. Largohet nga PD-ja dhe për katër vite nuk është më deputet në Parlament. Gjatë kësaj kohe ai angazhohet në formacionin politik “E djathta e bashkuar”, ku ishin pjesëtare disa parti të djathta, ndër të cilat edhe PR-ja. Në vitin 1999 në momentin kur Genc Pollo shkëputet nga PD-ja dhe krijon PDR-në, Dashmir Shehi i bashkohet kësaj partie. Menjëherë pas zgjedhjeve të vitit 2001, ku ai zgjidhet deputet i PDR-së, largohet edhe nga kjo parti për disa mosmarrëveshje në organizimin e grupit parlamentar të saj. Më pas ai krijon Partinë Demokratike të Rindërtuar, dhe pak muaj më parë i bashkohet LZHK-së, dhe aktualisht është drejtues i fushatës elektorale të këtij grupimi politik.